

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kërkimet arkeologjike në Lin/ Konfirmohet shtrirja e sitit palafit mbi 6 hektarë
ADRESA	https://www.cna.al/kulture/kerkimet-arkeologjike-ne-lin-konfirmohet-shtrirja-e-sitit-palafit-mbi-6-i474997
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:59:17 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 13:57:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	de76f03d7558aef06de34c3e9252b2416cec7f40a8d523849f78c4e107a23d3d
TEKSTI	6c474b993c21d18c67b4d2eaeca0ea41097247320a738a68a0075d12021c1261
PAMJA	356371d8bf6d503d9e336e6d72c6a9516895a3d89add7d9038c6320fde93393

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ac15ac02adc925903d954ecc41350bc9cf0861f2428cb612e874bab46ba57e17
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ac15ac02adc925903d954ecc41350bc9cf0861f2428cb612e874bab46ba57e17>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)




English
English

Kërkimet arkeologjike në Lin/ Konfirmohet shtrirja e sitit palafit mbi 6 hektarë



23 Shtator 2026, 15:57, Kulturë CNA



Siti palafit i Linit vijon të zbulojë të dhëna të reja për historinë e vendbanimeve prehistorike në Europë. Studimet e fundit kanë konfirmuar një shtrirje prej më shumë se 6 hektarësh, duke e renditur sitin ndër vendbanimet palafite më të rëndësishme të rajonit.

Kërkimet, që po zhvillohen në tokë dhe nën ujërat e Liqenit të Ohrit, synojnë të përcaktojnë më saktë strukturën dhe shtrirjen e vendbanimit, ndërsa rezultatet e deritanishme po hapin rrugën për një projekt më të gjerë kërkimor në vitet e ardhshme.



Dre përfehirje së cilës arkeologjika të Linit në listën e UNESCO-s kërkimet shkencore në këtë zonë vlerësojnë me metoda që nuk dëmtojnë shtrësit arkeologjike

... dhe për mënyrën se si shpërndahet materialet në zonën e studimit, si dhe për mënyrën se si ndryshojnë kushtet klimatike në zonën e studimit.

Gjatë këtij sezoni janë përdorur karotazhe manuale për marrjen e kampioneve nga shtresat kulturore, ndërsa paralelisht po kryhen studime gjeofizike për identifikimin e strukturave që mund të udhëheqin gërmimet e ardhshme.

“Kemi të bëjmë me një sit i cili është më i madh se 6 hektarë. Kjo na intereson për të planifikuar edhe ndërtuar një strategji ndërhyrjeje më të mirë për sa i përket pjesës së njohjes dhe studimit të këtij siti. Kryesisht kemi përdorur metoda të cilat bëjnë kampionimin e shtresave kulturore nëpërmjet karotazheve manuale, ku materiali i rikuperuar është në një gjendje shumë të mirë konservimi”, -tha Adrian Anastasi, Drejtues i Kërkimeve.

Një pjesë e rëndësishme e kërkimeve po zhvillohet edhe nën ujë. Studiuesit po analizojnë strukturat mbrojtëse të vendbanimit, të njohura si palisata, ndërsa kampionet dendrokronologjike po ndihmojnë në përcaktimin e karakteristikave dhe kronologjisë së tyre. Pikërisht ruajtja e jashtëzakonshme e materialeve organike e bën Lini 3 një sit me interes të veçantë për arkeologjinë europiane.




Bashkëdrejtuesi i projektit, Martin Hinz nga Universiteti i Bernës, e konsideron sitin si një prej pikave më të rëndësishme për studimin e prehistorisë në Shqipëri dhe Europë. Sipas tij, vendbanimi përfaqëson rreth 2 mijë vjet histori banimi, ndërsa kombinimi i kërkimeve në tokë dhe nën ujë mundëson studimin e një sasive të madhe materialeve organike të ruajtura.


“Doli të jetë një nga vendbanimet më të vjetra me palafite në Evropë dhe ka një potencial gjigant, gjithashtu për shkak të ruajtjes së materialit këtu dhe për faktin se përfaqëson 2,000 vjet histori banimi, duke nisur nga viti 5,800 para Krishtit e deri në vitin 4,000 para Krishtit”, -tha Hinz.

Kërkimet e këtij viti shërbejnë si fazë përgatitore për një projekt më të madh, që pritet të vijojë në vitet e ardhshme. Studiuesit po ndërtojnë gjithashtu një model 3D të zonave ende të pagërnuara, për të përcaktuar shpërndarjen e shtyllave prej druri dhe për të kuptuar më qartë shtrirjen e plotë të vendbanimit.



Studimet e mëtejshme pritet të sjellin të dhëna të reja për organizimin, strukturën dhe mënyrën e jetesës së komuniteteve që banonin në zonën e Linit mijëra vite më parë. Studiuesit shqiptarë dhe të huaj synojnë që kërkimet e ardhshme ta zgjerojnë më tej njohjen e një prej siteve më të rëndësishme palafite të rajonit./CNA





Të sugjeruara

Korça, arenë e muzikës në "Serenights Festival"/ Artistët tregojnë emocionet për CNA

Shkrimtari i njohur shpallet "Qytetar Nderi" i Kolonjës

"Serenights Festival"/ Mes traditës dhe muzikës bashkëkohore, Korça bashkon brezat

Nis edicioni i tretë i "Serenights festival" në Korçë

Guximi i katër të rinjve/ Si djemtë e Shkollës Teknike elektrifikuan Durrësin më 1930

Një jetë në artin shqiptar/ Reshat Arbana feston 86-vjetorin e lindjes

"Ditëlindja" letrare në Pogradec/ Promovohet novela e autorit Fate Velaj

Letërkëmbimi pasionant mes Albert Kamy dhe Simone de Beauvoir, dy prej mendjet më brilante të një shekulli

Shqipëria ka qenë toka e njeriut të lirë, e njeriut të ashpër dhe zemërmirë...

Për Valin e Martaneshit/ Fshati i Babëgjyshit, fshati më i mirë...

"Njeriu po e shkatërron Tokën"/ Patriarku Bartolome ndan mesazh kumbues për krizën ekologjike

Pikëtakimi në Pogradec/ Nis edicioni i 17-të i Kolonisë Ndërkombëtare të Artit

Ngre siparin edicioni i 13-të i "KoKo Fest"/ Mozaik shfaqjesh dhe artistësh në Korçë

Eteri kundër hapësirës dhe kohës, fushëbeteja ku gjenitë e shkencës u përplasën

Holanda tërhiqet nga Eurovision 2027: Konkursi nuk është më neutral

Vincenzo Peruggia, ai që vodhi Mona Lizën e Leonardo da Vincit, duke e ngjitur atë në panteonin e kryeveprës

Profeti Muhamed për Krishtin: "Unë jam më i afërti prej të gjithë njerëzve me birin e Merjemes (Marisë)"

Nudot artistike të Gjon Milit

Teatri "i papërshkueshëm nga zjarri"/ Mori jetën e 602 spektatorëve brenda 8 minutave


Festë e madhe për besimtarët ortodoksë/ Nesër kremtohet Dita e Shën Mërisë


[editorial](#)

16:30 Editorial

Agasi, Veliaj, Proda, Hyseni; Harta e një shteti që po shpërbëhet

CNA LIVESTREAM





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.